



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

Në bazë të nenit 12. Paragrafi 12.2. shkronja c) e Ligjit për vetëqeverisjen lokale me nr. 03/L-040 , nenit 97. të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit me nr. 03/L-025 dhe nenit 32. paragrafi 32.2. të Statutit të komunës së Dragashit me Nr. 01-06 – 103/1, Kuvendi i Komunës së Dragashit në mbledhjen e mbajtur me 15.08.2013 , miratoi këtë:

RREGULLORE
PËR
MBROJTJEN E MJEDISIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore krijohet baza juridike për promovimin e ngritjes së mjedisit të shëndetshëm për qytetarët e Komunës së Dragashit (më poshtë e quajtur: Komuna), në mënyrë që është e përballueshme dhe në përputhshmëri me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Komunës.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo Rregullore përcakton të drejtat dhe detyrimet e personave apo ndërmarrjeve për promovimin e mjedisit të shëndetshëm në Komunë.

Neni 3

Përkufizimet

"Mjedisi" - është rrethina natyrore : ajri, toka, uji, klima, flora dhe fauna dhe trashigimia kulturore si pjesë e ambientit të cilin e ka krijuar vet njeriu.

"Ndotja e mjedisit" - është ndikimi i drejtpërdrejtë ose e tërthorët e materieve ndotëse ,apo i energjisë në mjedis e shkaktuar përmes aktiviteteve të njeriut ose përmes proceseve natyrore që kanë pasoja të dëmshme në cilin e mjedisit dhe në shëndetin e njeriut.

- "Degradim i mjedisit" - është proces i cenimit të cilësisë së mjedisit i shkaktuar nga proceset nga proceset natyrore dhe aktivitetet e njeriut.

- " Rizik " - është potenciali i ndonjë aktiviteti, qoftë i drejtpërdrejt ose i tërthortë,që mund të shkaktoj dëm - ndotje për mjedisin, jetën, shëndetin, e njeriut dhe të mirat materiale

- "Pëlqim mjedisor" - është autorizim me shkrim i nxjerr nga autoriteti kompetentë pajtim me Ligjin,ose aktin nënligjor me qëllim të marrjes së lejes së për ndërtim,

- "Leje mjedisore" - është dokument me shkrimi lëshuar nga Ministria në bazë të dispozitave ligjore, e kërkuar me qëllim që të merret leja e punës.

"Mbeturin"- është çdo substancë ose lëndë të cilën zotuesi e hedh, mendon ta hedh,ose është i detyruar ta hedh , në vende jo të caktuar për deponimin e mbeturinave.

"Vlerësimi i ndikimit të mjedisit" (VNM) është procesi i cili vlerëson përcaktimin e dëmeve të mundshme mjedisore nga ndërtimi dhe aktivitet tjera.

"Aksident mjedisor"- është ndodhja e pa pritur dhe e pa kontrolluar,përkatësisht disa ndodhi të cilat krijohen me lirim , derdhjen ose hedhjen e materieve të rrezikshme , prodhimin,qarkullimin, transportimin, përpunimin, magazinimin apo ruajtjen afatgjate në mënyrë jo adekuate.

Neni 4.

Përgjegjësit e komunës për administrimin e mbrojtjes së mjedisit

- 1.Organet komunale marrin pjesë në aktivitetet e mbrojtjes së mjedisit në bazë të autorizimeve dhe detyrave të dala nga dispozitat ligjore dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje.
- 2.Komuna është përgjegjëse për këto çështje mjedisore:
 - 2.1. krijimin e standardeve dhe aplikimin e parimeve të parapara në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit (më poshtë i quajtur: Ligji), të akteve tjera të nxjerra në bazë të Ligjit dhe kësaj Rregulloreje për operatorët lokalë, që nuk janë nën menaxhimin apo administrimin e AKP-së, (Agjencionit Kosovar të Privatizimit) dhe shërbimeve publike, në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
 - 2.2. sigurimin e veprimit të operatorëve sipas këtyre standardeve dhe parimeve të shënuara në nenin 6. Të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit Nr.03/L-025,
 - 2.3. Bashkëpunojnë me ministrin për përgatitjen e Planit për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda teritorit të komunës,

2.4. Përgatisin masat dhe sigurojnë informatat për qytetarët në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm,

2.5. çështjet tjera mjedisore që dalin nga Ligji për mbrojtjen e mjedisit dhe dispozitat tjera plotësuese të nxjerra në pajtim me Ligjin.

Neni 5.

Planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës e miraton Kuvendi komunal me shumicë votash.

Neni 6

Objektivat kryesore komunale për mbrojtjen e mjedisit

1. Organet komunale në territorin e vet do të jenë aktive në :

1.1. zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor si dhe zvogëlimin ose ndalimin e atyre aktiviteteve ekonomike dhe aktiviteteve të tjera që përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;

1.2. mbrojtjen e balancit të përgjithshëm ekologjik në territorin e Komunës;

1.3. shfrytëzimin racional dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe tokës bujqësore;

1.4. mbrojtja e pamjeve të vlefshme natyrore, dhe

1.5. ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit.

Neni 7

1. Të gjitha masat për mbrojtjen e mjedisit, standardet dhe aktivitetet do të projektohen dhe implementohen në mënyrë që të:

1.1. balancohen objektivat e mbrojtjes së mjedisit me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Komunës dhe

1.2. zvogëlohen shpenzimet në nivel të arsyeshëm që të mund të përballohen nga qytetarët e Komunës.

Neni 8

1. Individëve, ndërmarrjeve dhe organeve dhe organizatave tjera iu ndalohen aktivitetet që pa arsyeshmëri rrezikojnë peizazhet dhe lokalitetet nën mbrojtje në territorin e Komunës.
2. Organet dhe organizatat tjera komunale do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë në zhvillimin dhe përvetësimin e çdo mase, standardi apo aktiviteti që ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit.

DOKUMENTET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT-

Neni 9

1. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe akteve tjera të nxjerra në bazë të tij, do të hartojë Programin Komunal për Mbrojtjen e Mjedisit dhe programe pune të ngjashme.
2. Programin nga paragrafi paraparak e miraton Kuvendi i Komunës së Dragashit (më poshtë i quajtur: Kuvendi).

Neni 10

1. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në bashkëpunim me Drejtorin e Mbrojtjes, Shpetimit dhe Shërbimeve Publike, hartojnë Planin Hapësinor të Komunës, Planin për Menaxhimin e Resurseve Natyrore dhe planet e programet e zhvillimit, të përcaktuara me ligj, të cilat kanë ndikim në mjedis e të cilat duhet patjetër të përfshijnë vlerësimin e aktiviteteve të planifikuara dhe ndikimin e tyre mbi mjedisin.
2. Planifikimi hapësinor dhe logjistik - urban do të:
 - 2.1. përshkruajë masat për mbrojtjen e natyrës, lokaliteteve nën mbrojtje, ujit, tokës, hapësirave të gjelbëruara publike dhe zonave rekreative;
 - 2.2. definojë rrezikun mjedisor të lokacioneve të ndotura, lokacioneve të rrezikuara nga erozioni, nga hedhja e materialeve të papërpunuara dhe të definojë propozimin e masave për rehabilitimin e lokacioneve të tilla;
 - 2.3. përcaktojë masat dhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit për hapësirat e dedikuara për përdorimin e burimeve natyrore, ndërtimin e fabrikave industriale dhe ndërtimin e strukturave për përqendrimin e mbeturinave.

Neni 11

1. Vlerësimi i aktiviteteve të planifikuara përfshin analizimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit, ndikimin e mundshëm në mjedis të aktiviteteve të planifikuara, veprimet për zbutjen e tij si dhe zhvillimin ekonomik.
2. Plani Hapësinor i Komunës, para aprovimit në Kuvend, i dërgohet në vlerësim (dhënien e mendimit profesional) Agjencionit të Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit.

Neni 12

1. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në bashkëpunim me Drejtorin e Mbrojtjes, Shpëtimit dhe Shërbimeve Publike, në bashkëpunim me organet tjera komunale, i paraqesin Kuvendit raport njëvjeçar për gjendjen e mjedisit.
2. Raporti përfshin, veç tjerash, të dhëna për:
 - 2.1. gjendjen ekzistuese të mjedisit dhe ndryshimet në mjedis;
 - 2.2. ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës në Komunë;
 - 2.3. dëmet mjedisore;
 - 2.4. qëndrueshmërinë e përdorimeve të burimeve natyrore;

Neni 13

1. Organet komunale raportojnë në Kuvend komunal edhe për:
 - 1.1. implementimin e programit për mbrojtjen e mjedisit në Komunë dhe programet e punës, si dhe efektin e tyre në zhvillimin ekonomik;
 - 1.2. marrjen e masave për mbrojtjen e natyrës, sukseset nga masat e marra dhe efektin e tyre në zhvillimin ekonomik;
 - 1.3. analizat për funksionimin e organeve komunale dhe veprimtaritë e operatorëve që ofrojnë shërbime publike;
 - 1.4. evaulimin e shpenzimeve në të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen për ndikimin ekonomik në aktivitetet mjedisore të bëra nga Organet komunale.

MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni 14

1. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në bashkëpunim me Drejtorin e Mbrojtjes, Shpëtimit dhe Shërbimeve Publike, në përputhje me aktet që nxjerr Qeveria e Kosovës (me poshtë e quajtur: Qeveria), do të përcaktojë rregullat e veprimit të subjekteve që marrin pjesë në biznesin e menaxhimit, përqendrimit, transportit dhe administrimit të mbeturinave në territorin e Komunës. Këto rregulla do të përmbajnë kërkesat teknike dhe kriteret për:

- 1.1. vendndodhjen ose krijimin e një strukture për mbajtjen dhe hedhjen e mbeturinave;
- 1.2. lokacionin, klasifikimin, vendosjen dhe transportimin e mbeturinave;
- 1.3. ripërpunimin, shfrytëzimin dhe metodat tjera të ripërdorimit të mbeturinave;
- 1.4. mbledhjen, shkatërrimin ose trajtimin e mbeturinave, dhe
- 1.5. përdorimin e mbeturinave si material për prodhimin e energjisë, materialeve të pa përpunuara, etj.

Neni 15

1. Drejtoria e Mbrojtjes, Shpëtimit dhe Shërbimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nxjerr Vendimin për paralajmërim, rekomandime dhe masa mbrojtëse të popullatës në territorin e Komunës në rast të ndotjes e cila tejkalon nivelet kritike të vlerave të kufizuara për shkarkimin dhe shpërndarjen e materieve ndotëse, përfshirë materialet ndotëse të ngurta, të lëngëta dhe të gazta në ajër, ujë dhe tokë.

Neni 16

1. personat juridik dhe fizik në territorin e komunës të cilët kanë dijeni për dëmtim të mjedisit ose aksident ekologjik duhet të njoftojnë Shërbimin e Inspektionit dhe Drejtorin për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbimeve Publike, për ndotje. Institucionet publike të Komunës do të bashkëpunojnë me inspektoratin mjedisor në kërkimin e arsyes për dëmet specifike mjedisore në territorin e Komunës.

2. Policia dhe zyrtarët tjerë publikë të autorizuar, të cilët gjatë kohës së kryerjes së detyrës së tyre zyrtare vijnë në dijeni lidhur me aksidentet ekologjike ose çrregullim tjetër mjedisor në territorin e Komunës, do të njoftojnë menjëherë inspektoratin mjedisor ose personin tjetër kompetent në drejtori.

3. Institucionet administratës Komunale do të bashkëpunojnë me ato qendrore të Republikës së Kosovës dhe ta ndihmojnë inspektoratin mjedisor në gjetjen e shkaqeve të çrregullimeve mjedisore dhe të përgjegjësit për çrregullime.

Neni 17

Instrumentet për mbrojtjen e mjedisit

1. Mbrojtja e mjedisit rregullohet me:

1.1. dokumentet për mbrojtjen e mjedisit,

1.2. instrumentet ekonomike, (janë: Fondi për mbrojtjen e mjedisit

1.3. dokumentet për vlerësimin e ndikimit në mjedis

1.4. instrumentet për monitorimin mjedisit dhe Menaxhimin e mbrojtjes së mjedisit nga personat juridik dhe fizik. (janë: ato instrumente të cilat përmenden në nenin 9. Të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit

Neni 18

Shfrytëzimi i resurseve natyrore

1. Personat juridikë ose fizikë mund të kryejnë aktivitete në hulumtimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore në territorin e Komunës sipas këtyre kushteve:

1.1. t'i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me nenin 8 dhe 9. të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit me nr.03/L-025

1.2. të respektojë dispozitat ligjore dhe rregullat lidhur me aktivitetet e tij;

1.3. nëse burimi natyror është pronë publike, të ketë koncesion ose ndonjë të drejtë tjetër adekuate për përdorimin dhe shfrytëzimin e burimeve në përputhje me ligjin;

1.4. gjatë aktivitetit, të zvogëlojë çrregullimet mjedisore që rrjedhin prej tij dhe

1.5. pas ndërprerjes së veprimtarisë, të rehabilitojë ose rikthejë mjedisin në gjendje të mëparshme, në përputhje me projektin e rehabilitimit.

2. Për projekte të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, projekti i rehabilitimit duhet të përfshihet në raportin e ndikimit në mjedis.

Neni 19

Pëlqimi për shfrytëzim

1. Institucionet komunale nuk mund të lëshojnë lejen për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor,

2. Pëlqimin për shfrytëzimin e resurseve natyrore duhet kërkuar në Ministrinë përkatëse.

Neni 20

Masat e mbrojtjes dhe rehabilitimi

1. Kur mund të dëshmohet për neglizhencën, aktet e paramenduara apo shkeljet nga ana e një personi, ndërmarrjeje apo organi publik në territorin e Komunës që sjell një dëm apo aksident mjedisor, personi, ndërmarrja apo organi publik do të detyrohet ta kthejë pjesën e dëmtuar në gjendje që nuk paraqet rrezik për shëndetin publik apo në gjendje të përgjithshme regjeneruese të pjesës së dëmtuar.

2. Në rast se një person, ndërmarrje ose organ publik në territorin e Komunës merr pjesë në një aktivitet të vazhdueshëm që mund të sjellë dëm ose aksident mjedisor, personit, ndërmarrjes apo organit publik do t'i kërkohej të ndërmarrë masa të arsyeshme që të sigurojë që aktivitetet e tilla në të ardhmen të bëhen në mënyrë që të:

2.1. zvogëlohet shkarkimi dhe shpërndarja në nivelin e lejueshëm dhe

2.2. minimizohet rreziku për një aksident mjedisor.

3. Nëse pala përgjegjëse për dëmin mjedisor nuk mund të gjendet ose në rastet kur personi apo ndërmarrja nuk kanë fonde të mjaftueshme të rregullojnë dëmin mjedisor, Bordi i Drejtorëve - (Këshilli i drejtorëve), por ma mirë është Drejtoria komunale për Urbanizëm, kadastër dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në rast se dëmi paraqet rrezik të vazhdueshëm për shëndetin publik, mund të hartojë dhe të implementojë një program të arsyeshëm për rregullimin e dëmit. Në rast se në çdo kohë, në fillim apo gjatë programit të tillë, pala përgjegjëse zbulohet, Komuna mund të rimarrë shumën e shpenzuar për rregullimin e dëmit të bërë nga neglizhenca, akti me paramendim apo nga shkelja e palës.

Neni 21

Vlerësimi i ndikimit në mjedis

1. Personat fizik dhe personat juridik që planifikojnë të ndërtojnë një objekt industrial, objekt të përpunimit të materialeve të ndryshme, punë apo vepër me projekte të mëdha, e në qoftë se

një projekt i tillë ka potencial të bëjë dëm mjedisor, do të bëjë vlerësimin e ndikimit në mjedis (më poshtë i quajtur: VNM).

2. Personi, ndërmarrja apo organi publik që planifikon të modifikojë operimin e një objekti industrial apo për përpunim, në rast se kjo paraqet një rrezik potencial për të rritur apo zmadhuar shkarkimin ose shpërndarjen e dëmit mjedisor, duhet të bëjë VNM-në.

3. VNM-ja nuk do të kërkohet në rast të ndërtimit apo modifikimit të ndërtesave rezidenciale, komerciale jo industriale brenda rajoneve të parapara për ndërtim të tillë me planin hapësinor në fuqi.

Neni 22

Vlerësimi i ndikimit në mjedis do të bëhet në përputhje me aktin e veçantë të cilin e nxjerr Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (më poshtë e quajtur: Ministria).

Neni 23

Të gjithë nëpunësit civilë që kanë kompetenca për të lëshuar leje ndërtimi, të gjithë personat apo ndërmarrjet që mbajnë leje për të filluar aktivitetet e ndërtimit, janë të detyruar t'i nënshtrohen trajnimit bazik për VNM - në bazë të kërkesave nga neni 20 i Ligjit dhe në bazë të akteve plotësuese normative që nxjerr Qeveria.

Neni 24

Masat e veçanta për mbrojtjen e mjedisit

1. Për rastet e aksidenteve të mundshme ekologjike ose rastet e rrezikimeve të jashtëzakonshme të mjedisit, rrezikimit të shëndetit dhe jetës së njerëzve në territorin e Komunës, Këshilli i Drejtorëve, me propozim të Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime publike dhe të Drejtorisë të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nxjerr Planet e intervenimit për territorin e saj.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1 i këtij neni, përmbajnë:

2.1. llojet e rrezikshmërisë si pasojë e aksidentit ekologjik,

2.2. procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta të dëmshme për mjedis,

2.3. organet për zbatimin e masave të caktuara,

2.4. përgjegjësitë dhe autorizimet lidhur me zbatimin e masave.

Neni 25

Mbrojtja e ajrit

Subjektet të cilat disponojnë me burim të ndotjes së ajrit (ndotësit e ajrit) janë të obliguara që, me masa tekniko - teknologjike dhe me masa tjera, të sigurojnë që shkarkimet dhe shpërndarjet në ajër të jenë në kufijtë e vlerave të përkufizuara dhe përcaktuara me ligj dhe aktet tjera.

Neni 26

Mbrojtja e ujit

1. Në përputhje me aktet e veçanta normative të Qeverisë, dhe me mundësitë e Komunës që të përballojë këto nivele, do të themelohen nivelet maksimale të lejueshme të shkarkimit dhe shpërndarjes të ndotësve të ujit.
2. Duke respektuar standardet dhe rregullat mbi vlerat e përkufizuara të ndotjes së ujit, ndalohet:
 - 2.1. shkarkimi në ujëra i materieve toksike dhe jotoksike, të ngurta, të lëngëta ose të gazta, organizmave të gjallë duke përfshirë edhe organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe formave të energjisë që shkaktojnë ndryshimin e kthjelltësisë, dekantimit, shtresimit dhe aromës ose ndryshime tjera në cilësinë e ujit;
 - 2.2. shkarkimi në sistemet publike të kanalizimit i ujërave të ndotura, të cilat përmbajnë substanca mbi vlerat e përkufizuara ose materiale të tilla të dëmshme, të cilat mund të shkaktojnë probleme në sistemin e kanalizimit ose objekteve për pastrimin e ujit; dhe
 - 2.3. përdorimi i puseve të braktisura si gropa septike për ujëra të ndotura.

Neni 27

Mbrojtja e tokës

Personat juridikë dhe fizikë të cilët me aktivitetet e tyre në territorin e Komunës, bëjnë hulumtimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore, grumbullimin e mbeturinave, hirit, ngjyrës ose materialeve tjera, ose që kryejnë aktivitete tjera të cilat e degradojnë shtresën prodhuese, ose shkaktojnë erozion të tokës apo ndryshim në regjimin e ujit, duhet të riformojnë shtresën sipërfaqësore të tokës, rivendosin regjimin e mëparshëm ujqor dhe stabilitetin gjeo - mekanik të tokës gjatë veprimtarisë dhe pas përfundimit të këtyre aktiviteteve.

Neni 28

Mbrojtja nga zhurma

1. Drejtoria e Mbrojtjes, Shpëtimit dhe Shërbimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrin dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në përputhje me dispozitat e nxjerra nga Ministria, ndërmer masa për mbrojtjen nga zhurma dhe në aktet e planifikimit hapësinor i caktojnë zonat e vendbanimeve, zonat për pushim dhe rekreacion si dhe bëjnë matjet sistematike të zhurmës dhe vibrimeve.

Neni 29

IV. MBROJTJA E NATYRËS

1. Zonat me vlera të veçanta natyrore, me interes për Komunën, gëzojnë mbrojtje të veçantë me ligj dhe aktet tjera të nxjerra në pajtim me ligjin .
2. Mbrojtja dhe ruajtja e tërësishme e natyrës, në territorin e Komunës, shfrytëzimi i qëndrueshëm i vlerave natyrore, kategorizimi i zonave me vlera të veçanta, procedurat e vënies nën mbrojtje, mbrojtja e llojeve të rralla e të rrezikuara të florës dhe faunës, regjimi i mbrojtjes sipas shkallës së kategorizimit, mënyra e menaxhimit të tyre, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje mbi natyrën si dhe mbikëqyrja profesionale e zonave me vlera të veçanta të natyrës bëhet në bazë të dispozitave të veçanta ligjore.

Neni 30

Informimi për mbrojtjen e mjedisit

1. Drejtoria mban të dhëna, të cilat nuk janë pjesë e Sistemit Informativ për Mbrojtjen e Mjedisit, e të cilat përfshijnë pa kufizim:
 - 1.1. të gjitha subjektet që ndërmarrin veprimtari të autorizuar dhe veprimtaritë e tyre;
 - 1.2. kërkesat për miratim, licencat dhe autorizime të tjera të tilla që kërkohen e jepen dhe çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me to;
 - 1.3. çfarëdo informacioni tjetër të marrë ose të siguruar sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit apo akteve tjera normative;
 - 1.4. hollësi për gjopa të vendosura sipas Ligjit dhe akteve tjera normative.

Neni 31

V. MBIKËQYRJA INSPEKTUESE

Mbikëqyrjen inspektuese të zbatimit të masave për mbrojtjen e mjedisit dhe mbikëqyrjen e çrregullimeve mjedisore në territorin e Komunës, ndikimi i të cilave nuk kalon kufijtë e Komunës dhe të cilat mund të zgjidhen, kontrollohen dhe parandalohen nga organet komunale, e bën inspektori komunal për mjedis, në përputhje me këtë Rregulloreje.

Neni 32

Procedura e ankesës

1. Në procedurën e ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese, në rastet e marrjes së masave për urdhëresa dhe ndalesa, inspektori i mjedisit nxjerr vendim.
2. Kundër vendimit të inspektorit komunal për mjedis, ankesa i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

VI. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 33

1.Me gjobë prej 500 deri në 1.000 € për shkelje ekonomike do të dënohet personi fizik dhe juridik nëse:

- 1.1 shfrytëzon burimet natyrore pa leje për shfrytëzim
- 1.2 fillon realizimin e projektit pa hartimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe pa pëlqimin e organit kompetent ,
- 1.3. nuk ndërmerri masa sanimi me shpenzime të veta,
- 1.4. kryen veprimtari në të mirat natyrore me rëndësi të veçantë me të cilat rrezikohet kapaciteti i mjedisit, ekuilibri natyror, vlerat natyrore e kulturore ,
- 1.5. largon dhe hedh mbeturinat dhe materiet e rrezikshme në mjedis jashtë lokacioneve të destinuara për këtë.

Neni 34

1.Me gjobë prej 200 deri në 800 € për kundërvajtje do të dënohet personi fizik ose personi juridik nëse:

- 1.1. vepron në kundërshtim me dispozitën e Rregullores;
- 1.2. pengon inspektorin komunal në kryerjen e obligimeve të shënuara në këtë Rregullore.

Neni 35

Me gjohë prej 100 deri në 200 € do të dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës në organin e administratës, përkatësisht në organizatën e cila kryen shërbime publike nëse nuk informon opinionin dhe nuk nxjerr aktin e fuqizimit të masave në rastet nga neni 24 i Rregullores.


VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 336

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Dragash.

01. NR.06-1249/1
15.08.2013

KUVENDI I KOMUNËS SË DRAGASHIT

KRYESUESI

Shaban Shabani

